



ASOCIACIONI I KOMUNAVE  
TE KOSOVES  
№ 237/15  
Data 16/06/2015  
PRISHTINE

Asociacioni i Komunave të Kosovës

---

## STATUTI

I

ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

Prishtinë

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'S. G. G.', is written over a horizontal line.

Në bazë të nenit 31 të Ligjit për Vetëqeverisje Komunale nr. 3/L - 040 (" Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28.2008), nenit 10 të Kartës Evropiane të Autonomisë Komunale, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.1999/22, dhe në bazë të nenit 5 paragrafi 2 të ligjit Nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Asociacionit të Komunave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16.06.2015 merr vendim për plotësim-ndryshim për :

## **STATUTIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS**

### **I.DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

- 1.1.** Statuti i Asociacionit të Komunave të Kosovës është akti më i lartë juridik i Asociacionit që miratohet nga Kuvendi i Asociacionit në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës ;
- 1.2.** Statuti është bazë për sigurimin e zbatimit të kompetencave dhe përgjegjësive të Asociacionit ashtu siq është e përcaktuar me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës ;
- 1.3.** Statuti rregullon objektivat,organet e Asociacionit dhe përgjegjësitë e tyre, të drejtat, detyrat,përgjegjësit e anëtarëve të Asociacionit dhe administrimin financiar të Asociacionit ;

#### **Neni 2**

##### **Përkufizimi**

- 2.1.**Asociacioni i Komunave të Kosovës (në tekstin e mëtejme Asociacioni) është organizatë joprofitabile, është person juridik, i themeluar nga komunitetet e Republikës së Kosovës dhe i përfaqëson interesat e përgjithshme të tyre ;
- 2.2.** Aktivitetet e Asociacionit janë të bazuara në parimet e vullnetarizimit të anëtarëve të saj, në parimet e demokracisë dhe në parimet e decentralizimit të pushtetit ;
- 2.3.**Anëtarë të Asociacionit janë autoritetet komunale të Republikës së Kosovës ;
- 2.4.**Autoritetet komunale anëtarësohen në Asociacion pas vendimit të marrë nga Kuvendi i Komunës përkatëse ;
- 2.5.**Emërtimi i Asociacionit është: ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS; akronimi AKK / THE ASSOCIATION OF MUNICIPALITIES OF KOSOVO; akronimi AMK / ASOCIJACIJA OPŠTINA KOSOVA / AOK ;
- 2.6.**Asociacioni ka xhirollogarinë e vet, emblemen në të cilin shkruan: Asociacioni i Komunave të Kosovës ;
- 2.7.**Kohëzgjatja e aktiviteteve të Asociacionit nuk është i kufizuar;
- 2.8.**Selia e Asociacionit është në: Prishtinë ;

## **II. OBJEKTIVAT DHE DETYRAT E ASOCIACIONIT**

### **Neni 3**

**3.1.** Asociacioni angazhohet që në Republikën e Kosovës të implementohen rregullat nga Karta Evropiane për qeverisjen komunale; të organizoj dhe koordinoj aktivitetet e anëtarëve të Asociacionit në sferën e investimeve, në zhvillimin ekonomik të komunave, në përmirësimin e bazës ligjore, të përkrahjes së biznesit, në kulturë, arsim, shkencë, mbrojtje shëndetësore, në mirëqenje dhe shërbime sociale, në përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe në raportet me asociacionet simotra jashtë shtetit dhe me organizatat ndërkombëtare ;

**3.2.** Asociacioni kryen keto detyra dhe punë:

**3.2.1.** inicon, organizon dhe promovon bashkëpunimin në mes autoriteteve komunale të Republikës së Kosovës, propozon zgjidhjen e problemeve të përgjithshme të autoriteteve komunale, nxjerrë materiale metodologjike të cilat ua jep autoriteteve komunale ;

**3.2.2.** jep mendime, sygjerime dhe vëretje në projekt ligjet dhe aktet nënligjore që kanë të bëjnë me qeverisjen komunale ;

**3.2.3.** bën asistencë organizative dhe ligjore për autoritetet komunale ;

**3.2.4.** përfaqëson interesat e përgjithshme profesionale të autoriteteve dhe shërbimeve civile nga autoritetet komunale ;

**3.2.5.** përfaqëson interesat e anëtarëve të saj para autoriteteve të jashtme dhe organizatave ndërkombëtare dhe ndihmon autoritetet komunale që të bashkëpunojnë me partnerët e jashtëm ;

**3.2.6.** organizon dhe koordinon trajnime profesionale për autoritetet komunale ;

**3.2.7.** organizon dhe koordinon qarkullimin e informacioneve për anëtarët e vet dhe nxjerr publikime të veta ;

**3.2.8.** hap zyra përfaqësimi, krijon mekanizma për ngritjen e kapaciteteve për autoritetet komunale ;

**3.2.9.** kryen shërbime të tjera për anëtarët e vet ;

## **III. ORGANET UDHËHEQËSE TË ASOCIACIONIT DHE ADMINISTRATA**

### **Neni 4**

**4.1.** Organet e udhëheqjes të Asociacionit janë: Kuvendi, Këshilli dhe Bordi i Asociacionit;

**4.2.** Organi më i lartë i udhëheqjes së Asociacionit është Kuvendi të cilin e përbëjnë të gjithë anëtarët e asociacionit. Në Kuvend marrin pjesë edhe përfaqësuesit e minoriteteve ;

**4.3.** Autoritetet komunale (kuvendet e komunës) e delegojnë për çdo 10 anëtar 1 (një) përfaqësues në Kuvendin e Asociacionit ;



- 4.4. Autoritetet komunale do t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre për përfaqësim në Kuvendin e Asociacionit. Përfaqësuesit (anëtarët e kuvendit) mund të zëvendësohen me vendim të Kuvendit të Komunes, por në bazë të dispozitave 4.3. të këtij akti ;
- 4.5. Kuvendi i rregullt do të mbahet jo më vonë se tre muaj pas zgjedhjeve komunale dhe shpalljes së rezultatit të tyre, Kuvendi do të mbledhet së pakunjë (1) herë në vit. Mbledhjet i thërret dhe udhëheq Kryetari i Asociacionit, i cili propozon edhe rendin e ditës të cilin e aprovon Kuvendi ;
- 4.6. Vendi i mbajtjes, data dhe rendi i ditës do të shpallet më së largu një (1) muaj para mbledhjes. Të gjitha materialet do t'u dërgohen anëtarëve të Kuvendit jo më vonë se një javë para mbledhjes ;
- 4.7. Mbledhjet e paparapara (të jashtëzakonshme) të Kuvendit mund të konvokohen së paku një muaj pas paralajmërimit dhe kur për këtë e kanë dhënë pëlqimin 2/3 e anëtarëve ;
- 4.8. Vendimet janë të plotëfuqishme, nëse merren me shumicën e thjeshtë të votave nga anëtarët prezent dhe votimi bëhet në mënyrë të hapur ;
- 4.9 Statuti dhe rregulloret e Asociacionit miratohen, ndryshohen dhe plotësohen me votim të hapur me 2/3 e votave nga anëtarët që marrin pjesë në kuvend ;
- 4.10. Kryetari dhe Nënkryetari zgjedhen me shumicën e thjeshtë të votave gjatë votimit të hapur ;
- 4.11. Pushimi i punës së Asociacionit bëhet me vendim të Kuvendit dhe konsiderohet se asociacioni është shuar kur për këtë kanë votuar 2/3 e anëtarëve me votim të hapur ;
- 4.12. Kuvendi kryesohet nga Kryetari i Asociacionit, të cilin e zgjedh Kuvendi. Procesverbalet i mban sekretariati i Asociacionit. Mandati i Kryetarit është në përputhje me mandatin e zgjedhjeve komunale ;
- 4.13. Kuvendi miraton vendime për çështje në bazë të agjendës së aprovuar ;
- 4.14. Kuvendi i asociacionit miraton, ndryshon dhe plotëson Statutin e Asociacionit ;
- 4.14.1 nxjerrë dhe ndryshon rregulloren e punës, rregulloret dhe aktet tjera të përgjithshme të Asociacionit si dhe ndryshimet në këtë rregullore ;
- 4.14.2 konfirmon dhe ndërron shumën e pagesës për anëtarësi ;
- 4.14.3. pranon anëtarë të rinj dhe shkarkon - largon anëtarë në pajtim me dispozitat 2.3 dhe 5.3 ;
- 4.14.4. vlerëson dhe aprovon planin vjetor të punës, planin vjetor financiar, shpenzimet e Asociacionit ;
- 4.14.5. përcakton prioritetin e aktiviteteve dhe detyrave për Asociacionin ;
- 4.14.6. zgjedh komisionet e Asociacionit ;
- 4.14.7. zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e Asociacionit ;
- 4.14.8. aprovon simbolet e Asociacionit ;
- 4.14.9. merr vendim për pushimin e punës së asociacionit dhe emëron komisionin për likuidim të Asociacionit ;
- 4.14.10. zgjedh nga anëtarësia e tij anëtarët e Bordit dhe i shkarkon ;
- 4.14.11. Ushtron edhe funksione tjera të përcaktuara me ligjet pozitive dhe konventat ndërkombëtare ;
- 4.14.12. Kuvendi i Asociacionit mund të delegojë ndonjë prej përgjegjësive të tij në Bordin e Asociacionit ose ndonjë organ tjetër me vendimin e shumicës së anëtarëve ;



**4.15.** Në periudhën mes dy kuvendeve, Kuvendi i Asociacionit do të administrohet nga Këshilli i kryetarëve të Komunave. Këshilli do të mbledhet së paku çdo tre muaj. Mbledhjet e Këshillit kryesohen nga Kryetari i Asociacionit, i cili në të njëjtën kohë nënshkruan të gjitha vendimet e Këshillit ;

**4.15.1.** Këshillin e përbëjnë kryetarët e komunave dhe anëtarët e Bordit ;

**4.16.** Mbledhjet e Këshillit dhe vendimet konsiderohen të plotfuqishme, nëse në mbledhje kanë marrë pjesë më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të këshillit. Vendimet merren me vota të hapura dhe me shumicën e anëtarëve prezent. Nëse votimi është ndarë në dysh, vota e kryesuesit e përcakton vendimin ;

**4.17.** Këshilli i Asociacionit kryen:

**4.17.1.** me rekomandim të bordit analizon aktet dhe projekt vendimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivitetet e autoriteteve komunale ;

**4.17.2.** analizon çështjet e propozuara nga Bordi dhe çështjet e propozuara nga anëtarët e këshillit, dhe për këtë merr vendime të caktuara ;

**4.17.3.** kryen edhe funksione tjera të përcaktuara nga kuvendi i Asociacionit ;

**4.18.** Bordi i Asociacionit zgjidhet nga anëtarët e kuvendit të asociacionit. Bordi përbëhet prej 7 anëtarëve: kryetari, nënkryetari dhe pesë (5) anëtar tjerë. Bordi duhet të respektojë përfaqësimin pluralist. Bordi mbledhet me thirrje të kryetarit të asociacionit, i cili edhe kryeson mbledhjen dhe nënshkruan të gjitha vendimet e marrura;

**4.19.** Bordi i Asociacionit kryen :

**4.19.1.** diskuton problemet e ngritura në mbledhje të Kuvendit, të Këshillit, të kryetarëve dhe ofron zgjidhjet – propozimet ;

**4.19.2.** bën propozime dhe vërejtje, të cilat ia drejton organeve të pushtetit dhe qeverisë lidhur me përmirësimin e vetëqeverisjes komunale në pajtim me legjislacionin në fuqi ;

**4.19.3.** shqyrton raportet e kolegjiemeve ;

**4.19.4.** zbaton vendimet e Kuvendit dhe Këshillit për anëtarësim në ndonjë organizatë të pavarur ndërkombëtare ;

**4.19.5.** konfirmon marrëveshjet e Asociacionit ;

**4.19.6.** përcakton detyrat e obligueshme për administratën, përcakton strukturën e administratës ;

**4.19.7.** shqyrton aktivitetet financiare të Asociacionit ;

**4.19.8.** shqyrton planin e aktiviteve dhe raportin e administratës ;

**4.19.9.** konfirmon dhe përcakton listën e komisioneve, kolegjiemeve dhe rregulloreve ;

**4.19.10.** pranon dhe shkarkon drejtorin ekzekutiv përmes rrugës së konkurrencës së hapur (konkursit), pas autorizimit të marrë nga Kuvendi ;

**4.20.** Vendimi në Bord konsiderohet i plotëfuqishëm nëse për të kanë votuar më shumë se gjysma e numrit të anëtarëve të bordit ;

**4.21.** Bordi i Asociacionit vendos nëse është i nevojshëm krijimi i organeve të ndryshme konsultative ;

**4.22.** Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit fillon që nga dita e zgjedhjes në mbledhjen e kuvendit. Mandati i anëtarëve të Bordit është në përputhje me mandatin e zgjedhjeve komunale. Në rast se kryetari dhe nënkryetari ndërrojnë pozitën e tyre apo tërhiqen



nga aktivitetet në sistemin e autoriteteve komunale, atëherë edhe funksionet e tyre pushojnë. Në këtë rast këto funksione Këshilli ua beson anëtarëve të Bordit deri në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit ;

**4.23. Kryetari i Asociacionit kryen :**

**4.23.1.** organizon punën e organeve të brendshme menaxhuese të Asociacionit ;

**4.23.2.** përfaqëson Asociacionin para organeve shtetërore: para Presidencës, Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë, organizatave të pavarura ndërkombëtare ;

**4.23.3.** definon përgjegjësitë, autorizimet dhe kompetencat e nënkryetarit ;

**4.23.4.** me autorizim të Bordit nënshkruan marrëveshje ;

**4.23.5.** siguron kontinuitetin e aktiviteve të Asociacionit gjatë zgjedhjes së anëtarëve të rinj si përfaqësues të autoriteteve komunale pas zgjedhjeve të reja komunale ;

**4.24.** Aktivitetet e Asociacionit do të organizohen nga administrata që përcakton rregullat teknike për trupat menaxhuese të administratës. Administrata udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv . Administrata punon në bazë të ligjit, në bazë të rregulloreve për përgjegjësinë të aprovuar nga Kuvendi, në bazë të vendimeve të Kuvendit, të vendimeve të Këshillit, të Bordit dhe në bazë të urdhërave të drejtorit ekzekutiv ;

**4.25. Drejtori Ekzekutiv i Asociacionit :**

**4.25.1.** organizon dhe kryen aktivitetet e përditshme të Asociacionit ;

**4.25.2.** zgjidh çështjet organizative, ekonomike dhe financiare të administratës ;

**4.25.3.** i dorëzon Bordit për shqyrtim planet e punës dhe ato financiare dhe i jep informacion anëtarëve të Asociacionit për implementimin e vendimeve të Kuvendit ;

**4.25.4.** përfaqëson Asociacionin në gjykata, në raportet me persona tjerë juridik lidhur me kompetencën para organeve komunale dhe institucioneve shtetërore ;

**4.25.5.** kujdeset për punësimin, largimin nga puna dhe shqipton masa disiplinore për personelin e Asociacionit në bazë të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës ;

**4.25.6.** hap dhe mbyll xhirrollogarinë bankare ;

**4.25.7.** Drejtori Ekzekutiv është person i autorizuar i Asociacionit ;

**4.25.8.** nxjerr urdhëresa lidhur me punën e administratës ;

**4.25.9.** siguron mbrojtjen e pronave të Asociacionit dhe kujdeset për kushte më të mira të punës ;

**4.26.** Aktivitetet e komisioneve dhe kolegjiemeve janë të bazuara në rregulloret e Asociacionit ndërsa rregullat teknike kryhen nga administrata ;

**4.27.** Administrata zbaton ligjin për gjuhët në Kosovë ;

#### **IV. TË DREJTAT, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIA E ANËTARËVE TË ASOCIACIONIT**

##### **Neni 5**

**5.1.** Anëtarët e Asociacionit kanë të drejtë:

**5.1.1.** të pajisen lirisht me informata, të kenë asistencë metodologjike dhe shërbime tjera ;

**5.1.2.** të bëjnë propozime në asociacion për zhvillimin e vetëqeverisjes dhe për aktivitete të Asociacionit ;



**5.1.3.** të delegojnë përfaqësuesit në kuvend të Asociacionit dhe të zëvendësojnë ata në pajtim me dispozitat 4.3. dhe 4.4 ;

**5.1.4.** Kuvendi Komunal mund të merr vendim që të tërhiqet nga anëtarësimi në Asociacion. Para tërheqjes nga anëtarësia, komuna (autoritetet komunale) obligohet të paguajë anëtarësinë për kohën e kaluar – kohën për sa ishte anëtar ;

**5.2.** anëtarët e Asociacionit kanë obligim të :

**5.2.1.** paguajnë 0.10 € për kokë banori, ne bazë të shënimeve të Entit Statistikore të Republikës së Kosovës, për komunën përkatëse ;

**5.2.2.** t'i respektojnë rregulloret dhe vendimet e Kuvendit të Asociacionit dhe Këshillit ;

**5.3.** me rekomandimin e Këshillit të Asociacionit, Kuvendi i Asociacionit mund të përjashtoj anëtarin e Asociacionit, i cili ka shkelur dispozitat e rregullores dhe vendimi për përjashtim duhet të merret me 2/3 e votave të gjithë anëtarëve. Nëse nuk ka paguar anëtarësinë mbetet vetëm vëzhgues në Kuvendin e Asociacionit ;

## **V. PRONA, BURIMET E FINANCIMIT DHE PROCEDURAT PËR PËRDORIMIN E PASURISË**

### **Neni 6**

**6.1.** Prona e Asociacionit dhe fondet tjera përbëhen nga :

**6.1.1.** pagesa e anëtarësisë nga buxhetet komunale ;

**6.1.2.** të ardhurat nga publikimet dhe shërbimet ;

**6.1.3.** të hyrat nga niveli qendror, niveli lokal dhe nga jashtë ;

**6.1.4.** fondet nga dhuratat, nga ndihmat, donacionet si dhe fondet e marra nga ndonjë trashëgimi ;

**6.2.** Asociacioni përdor, administron fondet dhe disponon pronën në pajtim me rregulloren e Asociacionit dhe me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës ;

**6.3.** Prona e Asociacionit menaxhohet me përgjegjësi nga Drejtori Ekzekutiv . Pasuria e Asociacionit përdoret vetëm me qëllim të implementimit të objektivave të Asociacionit ;

### **Neni 7**

#### **7. Kontrolli i aktiviteteve financiare**

**7.1.** Kontrolli i aktiviteteve financiare të Asociacionit kryhet nga Auditori i Pavarur .

**7.2.** Administrata së bashku me Bordin bëjnë përzgjedhjen e ofertuesit për auditimin e pavarur ;

**7.3.** Auditori i Pavarur kryen inspektimin e aktiviteteve financiare të administratës, së paku një herë në vit i cili raport i paraqitet Bordit për miratim ;

**7.4.** Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me financat i jepen në shikim, në çdo kohë anëtarëve të Kuvendit të Asociacionit ;

**7.5.** Kuvendi i miraton raportet vjetore dhe financiare, të cilat përgaditen nga administrata e Asociacionit ;

## Neni 8

### 8. Shuarja e Asociacionit

- 8.1. Asociacioni pushon së ekzistuari me vendim të Kuvendit, nëse për këtë kanë votuar më shumë se 2/3 e të gjithë anëtarëve të Asociacionit ;
- 8.2. Asociacioni mund të pushojë me vendim të organeve të shtetit (organit që ka regjistruar Asociacionin), nëse në Asociacion mbesin më pak se gjysma e anëtarëve dhe nëse vendet tjera nuk janë plotësuar brenda një viti ;
- 8.3. Kuvendi, nëse merr vendim për pushimin e Asociacionit, duhet të emëroje komisionin për likuidim dhe të përcaktoj detyrat e tij ;
- 8.4. Komisioni i likuidimit obligohet të informoje të gjithë anëtarët e Kuvendit lidhur me procedurën e likuidimit ;

## VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

### Neni 9

- 9.1. Me hyrje në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve shfuqizohen të më parmet vlejë dispozitat sipas vendimit Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

## ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS



Drejtori Ekzekutiv

Sazan Ibrahimiri